VENDIM
Nr. 1, datë 10.4.2018

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT OPERACIONAL "ZHVILLIMI RAJONAL 2018–2019", TË GRANTEVE TË FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 109, datë 30.11.2017, "Për buxhetin e vitit 2018", Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e programit operacional "Zhvillimi rajonal 2018–2019", sipas drejtimeve prioritare të politikës së Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2018, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Financave dhe Ekonomisë, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Kulturës, ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Senida Mesi

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Përfaqësuesi i Fondit Shqiptar të Zhvillimit	anëtar.

Programi operacional

Programi operacional për zhvillimin rajonal (POZHR) është dokumenti kuadër që paraqet fokusin kryesor të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR), për periudhën 2018–2019, si edhe orientimet të shpërndarjes së fondeve të reja të FZHR-së.

Dokumenti është hartuar në përputhje me parashikimet në mbështetje të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", aneksi 3, ku përcaktohen rregullat e funksionimit të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR).

Programi operacional paraprihet nga kuadri strategjik i politikës së zhvillimit rajonal në Shqipëri, dhe kuptohet dhe zbatohet së bashku me të.

Kuadri strategjik i politikës së zhvillimit rajonal në Shqipëri

Kuadri dhe zhvillimi i politikës

Politikat e zhvillimit rajonal e kohezionit dhe instrumentet e lidhura me to janë pasqyrimi më i drejtpërdrejtë i qasjes territoriale, me qëllim sjelljen e perspektivës territoriale (horizontale), nëpërmjet koordinimit me instrumentet sektoriale (vertikale) dhe vendimmarrëse.

Arsyeja pas kësaj qasjeje i ka rrënjët në nevojën për ndërhyrje të integruara për zhvillimin e territoreve dhe fuqizimin e potencialeve social-ekonomike të rajoneve, inkurajimin e modeleve të

qëndrueshme të bashkëpunimit dhe partneriteteve për zhvillimin, reduktimin e diferencave socioekonomike midis rajoneve/territoreve dhe promovimin e fuqizimin e ekonomive lokale, rajonale e ndërrajonale.

Kuadri strategjik i politikës së zhvillimit rajonal përbëhet nga tërësia e dokumenteve strategjike dhe zhvillimore të lidhur në nivel qendror dhe vendor. Orientimet kryesore të politikës dhe të drejtimeve prioritare të saj vijnë nga kuadri strategjik i politikës që paraqet edhe politikën për zhvillimin rajonal dhe përbëhet nga[1]:

i) Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

ii) Dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale, sipas granteve të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, si dhe ato të zhvillimit rural;

iii) Plani i Përgjithshëm Kombëtar;

iv) Strategjitë e zhvillimit në nivel qarku dhe ato vendore;

v) Planet e detajuara vendore.

Ka filluar puna për të "pilotuar" hartimin e programeve operacionale mbi bazën e rajoneve të zhvillimit, siç është rasti i projektdokumentit të programit të rajonit nr. 2, si dhe i zhvillimit të mjeteve të tjera të lidhur me zhvillimin rajonal. Kontribut në këtë drejtim po japin edhe Agjencitë për Zhvillimin Rajonal dhe Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, me aktivitetin e tyre.

Në kuadër të progresit në procesin e çeljes së negociatave dhe të përgatitjes për integrimin në Bashkimin Evropian të vendit, veç kuadrit strategjik të politikës, orientimet kryesore të politikës dhe drejtimet prioritare të saj kanë ndikim orientues edhe nga politika për zhvillim rajonal e BE-së.

Konteksti i politikës rajonale të BE-së për zhvillimin rajonal

Fondi Evropian i Zhvillimit të Rajoneve[2] (FEZHR) për periudhën 2014–2020, i fokuson ndërhyrjet dhe investimet në disa akse prioritare, të njohura si "përqendrime tematike", përkatësisht:

- Inovacioni dhe hulumtimi;
- Agjenda digjitale;
- Mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME);
- Ekonomia e ulët e karbonit.

FEZHR-ja, gjithashtu, u kushton vëmendje të veçantë karakteristikave specifike territoriale. Masat e FEZHR-së janë projektuar për të reduktuar problemet ekonomike, mjedisore dhe sociale në zonat urbane, me fokus të veçantë në zhvillimin e qëndrueshëm urban.

Të paktën 5% e burimeve të FEZHR-së janë të vendosura përmes "veprimeve të integruara", të menaxhuara nga qytetet.

Zonat e pafavorizuara nga një këndvështrim gjeografik (zonat e largëta malore ose zonat me popullsi të ulët) përfitojnë nga trajtimi i veçantë. Së fundi, zonat larg qendrës, gjithashtu, përfitojnë nga ndihma specifike e FEZHR-së, për të trajtuar dizavantazhet e mundshme për shkak të largësisë së tyre.

Kuadri ligjor për zhvillimin rajonal

Ligji vjetor i buxhetit[3] përbën bazën kryesore ligjore të lidhur me funksionimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR), si instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues, që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe lokal, e cila si u përmend më lart derivon nga kuadri strategjik i politikës.

Sipas tij, qëllimi i FZHR-së është sigurimi i zbatimit të objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të pasur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor. FZHR-ja, për vitin 2018 përbëhet dhe financohet nga 6 grante

[1] Lista e dokumenteve strategjike të kuadrit strategjik të politikës në aneksin bashkëlidhur.

[2] http://ec.europa.eu/regional_policy/en/funding/erdf/

[3] Ligji nr. 109/2017, datë 30.11.2017, "Për buxhetin e vitit 2018".

konkurruese.

Vështrim në vitin pararendës (cikli 2017–2018)

Për vitin 2017, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve u orientua për financimin e projekteve të reja, që mbështesin ndërhyrjet e nisura dhe fuqizimin e impaktit të tyre, duke synuar rritjen e efektivitetit dhe të efikasitetit të politikave të zhvillimit rajonal.

Përgjatë vitit 2017, drejtimet prioritare të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve kanë qenë, ndër të tjera:

- Rivitalizimi i poliqendrave urbane dhe ekonomive lokale;
- Kohezioni territorial dhe zhvillimi rajonal;
- Stimulimi i zonave dhe i poleve potenciale*, cluster* të zhvillimit;
- Qytetet moderne, digjitalizimi dhe modernizimi i qyteteve - *Smart City*.

Programi i infrastrukturës vendore dhe rajonale, së pari, përmes grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, ka qenë i fokusuar në rikualifiminin urban të hapësirave dhe të infrastrukturës publike, duke synuar rivitalizimin e qytetit dhe të fshatit, zonave urbane dhe të lidhjes me ato rurale dhe, konkretisht ka orientuar ndërhyrje në sheshe dhe "qendra" urbane e rurale etj. Investimet e projektuara nga aplikuesit në këto hapësira, qartësisht kanë përmirësuar jo vetëm infrastrukturën, por edhe kanë kontribuar në rritjen dhe fuqizimin e ekonomive lokale, si edhe në rritjen e vlerës në zonat e investuara dhe përreth.

Në vitin 2017 janë vënë në realizim 66 projekte të reja, veç atyre në vazhdim, miratuar në vitin 2017 nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Në përmbledhje ato janë:

i) 15 projekte të ndërlidhjes së zonave rurale (nevojat për ndërhyrje, prodhim-tregje ose lidhjes me shërbimet), rrugësh rurale, p.sh., rikonstruksion i rrugës fshati Zaharishtë - Has, rikonstruksioni i rrugës Xhami – Golem në Kavajë, rikonstruksion i rrugës Gostim - Tregan në Elbasan, rikonstruksion i rrugës Pishporo – Bregdet - Fier, rikonstruksion i rrugës Kthesa e Pilurit - Himarë etj.;

ii) 30 projekte të ndërlidhjes së zonave urbane (nevojat për ndërhyrje dhe forcimi i lidhjeve rajonale ose ndërqytetase, si dhe i lëvizjes në qytete), rrugësh urbane, si p.sh., ndërtimi i *By Pass*-it Klos, unaza lindore në Kavajë, unaza e Pogonit në Dropull, zgjatim i unazës së Rrëshenit, rikonstruksioni i rrjetit rrugor Shijak etj.;

iii) 11 projekte të rivitalizimit të jetës komunitare dhe të mbështetjes së zhvillimit të potencialit të ekonomisë lokale dhe të potencialit për zona të përmirësuara biznesi në qytete, si sheshet dhe qendrat urbane, si p.sh., rikualifikimi i sheshit "Livadhja" - Finiq, i qendrës së Leskovikut, sheshi urban Zaranika - Elbasan, sheshi "Mustafa Merlika", Krujë, qendra e qytetit Bulqizë etj.;

iv) 10 projekte të përmirësimit të cilësisë së infrastrukturës së qyteteve (blloqeve dhe lagjeve të banimit), si p.sh., ndërhyrje dhe rehabilitim i fasadave: Vau i Dejës, Bajram Curri, në shëtitoren "Miqësia" në Poliçan, në qendrën e Belshit, në bulevardin "Republika" në Berat etj.

Granti i arsimit, ka mundësuar mbështesje në rehabilitimin e rreth 29 objekteve arsimore dhe terreneve sportive, si p.sh., shkolla "Saba Sinani", Pukë; shkolla "Gjocaj", Peqin; shkolla artistike "Jakov Xoxa", Fier; shkolla "Papa Kristo Negovani", Ersekë; shkolla "14 Nëntori", Durrës etj., si dhe p.sh., palestra sportive "Ismail Qemali", Vlorë; terrenet sportive të shkollës "Gaqi Karakashi" dhe "28 Nëntori", Kuçovë; rikonstruksion i ambienteve sportive shkolla "Gjin Pjetri", Kurbin etj.

Granti për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim ka mbështetur 2 projekte nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2017, atë të gjelbërimit dhe pyllëzimin e ambienteve përreth qyteteve Përrenjas dhe Vau i Dejës.

Programi "Shqipëria digjitale", ka pasur si synim të mbështesë inovacionin në ofrimin e shërbimeve dhe informimin e qytetarëve, përmes objektivit "Qytete të zgjuara" (*Smart Cities*), si dhe sistemet të administrimit publik dhe të shërbimeve të njësive të qeverisjes vendore apo infrastrukturën e ndërlidhjes digjitale. Granti "Shqipëria digjitale" ka mundësuar financimin e 5 projekteve nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2017, më konkretisht:

v) Projekte (sisteme infrastrukture) "*Virtual Smart City",* si p.sh., modeli 3D i qytetit Gjirokastër,

sistemi multifunksional "*Smart City*", Lungomare;

vi) Sisteme *Wi-Fi* dhe ndërtim i infrastrukturës përkatëse, si p.sh., sistemi për shkollat në Malësinë e Madhe dhe infrastrukturë komunikimi për Bashkinë Elbasan;

vii) Sistem i qendërzuar për monitorimin e detyrimeve të prapambetura Bashkia Tiranë.

Programi operacional 2018–2019

Për vitin 2018, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 6 grante, me financim nga buxheti i ministrive dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ligji parashikon që portofoli i fondit për vitin 2018, për projekte të reja, të ketë si kontribut edhe bashkëfinancimin nga njësitë e qeverisjes vendore dhe aplikuesit. Vlera e këtij bashkëfinancimi, sipas ligjit të buxhetit 2018, përcaktohet me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Për vitin 2018, për së pari, Fondi, përmes programeve buxhetore të granteve në ministrinë përkatëse dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, mbështet financimin dhe përfundimin e punimeve të objekteve në vazhdim, të cilat parashikohen sipas legjislacionit financiar në fuqi dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për vitin 2018 nuk parashikohen fonde për investime/projekte të reja, për:

1. Granti për infrastrukturë vendore dhe rajonale;
2. Granti për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor);
3. Granti për artin dhe kulturën;
4. Granti për ujësjellës-kanalizimet;
5. Granti për rehabilitimin mjedisor, gjelbërimin dhe pyllëzimin.

Për grantet "Arsimi" ku parashikohen fonde për investime/projekte të reja për vitin 2018–2019, si orientim/fokus të jetë "zgjerimi i ndërhyrjeve rehabilituese dhe të përmirësimit të kushteve në objektet arsimore, me qëllim rritjen e aksesit në shkolla dhe përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës shkollore dhe të mjediseve të tjera sportive dhe të shkollës qendër komunitare".

Drejtimet e thirrjes, për çdo thirrje për projekte të reja, në grantet e fondit, miratohen më konkretisht rast pas rasti, me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Mekanizmat institucionalë dhe instrumentet financiare

Në bazë të aneksit 3, të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", instrumenti i financimit, i cili adreson praktikisht disa aspekte dhe çështje të zhvillimit rajonal, është Fondi për Zhvillimin e Rajoneve. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përfaqëson një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal e vendor, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të pasur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 6 grante konkurruese:

1. Granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
2. Grantet për arsimin;
3. Granti për shëndetësinë;
4. Granti për artin dhe kulturën;
5. Granti për ujësjellës-kanalizimet;
6. Granti për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzimin.

Subjektet aplikuese dhe zbatuese (autoritetet kontraktore), përfituese të programeve, ndjekin rregullat, si më poshtë:

a) Aplikimi për financimin e projekteve nga fondet për infrastrukturën vendore bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjekte të kompetencave të përbashkëta të tyre, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, Agjencia Kombëtare për Zhvillim Rajonal, agjencitë për zhvillim rajonal nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, partneritetet ndërvendore dhe rajonale, agjentët zhvillimorë në nivel lokal dhe/ose rajonal. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat do të aplikojnë, duhet të sigurojnë kontributin nga buxheti i tyre si bashkëfinancim. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR) vendos vlerën e bashkëfinancimit për

çdo projekt.

b) Në rastet e projekteve me disa përfitues në skemat e partneritetit ndërvendor dhe rajonal ose në raste të tjera të veçanta, marrëveshja e partneritetit midis përfituesve cakton autoritetin kontraktor që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për miratim. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit, i cili mund të jetë njëri prej përfituesve dhe/ose Agjencia Kombëtare për Zhvillim Rajonal, dhe/ose Agjencia për Zhvillim Rajonal, dhe/ose Fondi Shqiptar i Zhvillimit, dhe/ose agjenti zhvillimor në nivel lokal dhe/ose rajonal, përfaqësues i partneritetit ndërvendor dhe rajonal.

c) Zbatimi i projekteve të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është përgjegjësi parësore e autoriteteve kontraktuese, në bashkëpunim me përfituesit përkatës për çdo projekt, të cilët zbatojnë projektet sipas rregullave dhe akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

ç) Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Sekretariatet teknike të programeve të zhvillimit të infrastrukturës vendore ngrihen në ministritë përkatëse të linjës dhe pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë:

i) Sekretariati teknik i grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale ngrihet pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit;

ii) Sekretariati teknik i grantit për arsimin ngrihet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

iii) Sekretariati teknik i grantit për shëndetësinë ngrihet pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

iv) Sekretariati teknik i grantit për artin dhe kulturën ngrihet pranë Ministrisë së Kulturës;

v) Sekretariati teknik i grantit për ujësjellës-kanalizimet ngrihet pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

vi) Sekretariati teknik i grantit për rehabilitimin mjedisor, gjelbërimin dhe pyllëzimin ngrihet pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

Kalendari i thirrjeve për projekte të reja 2018

Kalendari i thirrjeve për projekte të reja parashikohet sipas ciklit të zbatimit të buxhetit për vitin 2018 dhe hartimit të buxhetit për vitin 2019 etj., në përputhje me aktet dhe udhëzimet për këtë qëllim.

Thirrjet për projektet e reja, për ato grante ku parashikohen fonde për projekte te reja, zhvillohen gjatë periudhës prill–maj 2018, ndërsa për të parapërgatitur vitin buxhetor 2019, sipas parashikimit në aneksin 3, të ligjit të buxhetit 2018, thirrjet për vitin pasardhës mund të zhvillohen që në muajin nëntor të vitit paraardhës, pra në nëntor të vitit 2018.